**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË**
**Nr. Vendimi** 33/10

## VENDIM
### PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT FIZIK

Sot, më datë 29.06.2005, unë, Arjana Caco, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Alba Gina, për regjistrimin si person fizik,

### KONSTATOVA SE:

Alba Gina, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më datë 14.4.1977, me banim në Tiranë, Shqipëri, me adresë Rr. Dervish Hima nr. 1, ap.10/1, Tirane, ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për t'u regjistruar si person fizik me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes me pakicë te veshjeve dhe aksesoreve te tyre.

Veprimarinë do ta zhvillojë prane Qendres Tregatare Univers, km. 6 në Autostraden Tirane - Durres.

### PËR KËTO ARSYE:

Meqenëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit" dhe Ligjin nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

### VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës;
- Regjistrimin si person fizik të **Alba Gina,** shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më datë 14.4.1977, me banim në Tiranë, Shqipëri, me adresë Rr. Dervish Hima nr. 1, ap.10/1, Tirane për ushtrimin e veprimtarisë e veprimtarisë së shitblerjes me pakicë veshjeve dhe aksesoreve te tyre. Veprimtarinë, kërkuesi do ta zhvillojë prane Qendres Tregatare Univers, km. 6 në Autostraden Tirane - Durres.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

Tiranë, datë 29.06. 2005.

**GJYQTARE**

**ARJANA CACO**

PULLE TAKSE
100 LEKE R.SHQIPERISE

33110

7 A Caro 28 06 2005

## KËRKESË

28 QERSHOR 2005

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË,
SEKSIONIT TREGTAR

**KËRKUESI:** **Alba Gina,** shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më datë 14.04.1977, me banim në Tiranë, Rr. Dervish Hima, nr. 1, ap. 10/ 1, Shqipëri.

**OBJEKTI:** Regjistrim si Person Fizik në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7512, datë 10.08.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit", Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar".

Unë e nënshkruara **Alba Gina**, **shtetase** shqiptare, lindur në Tiranë, më datë 14.04.1977, me banim në Tiranë, Rr. Dervish Hima, nr. 1, ap. 10 kam vendosur të ushtroj veprimtarinë e shitjes se veshjeve e aksesoreve te veshjeve me pakice dhe me kete kerkese i kërkoj Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të më regjistrojë në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate si Person Fizik.

Veprimtarinë do ta zhvilloj në Qendren Tregtare Univers, Km. 6, autostrada Tirane - Durres.

KËRKUESI

Alba Gina

**Alba Gina**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr. 2197 Rep.**

## VËRTETIM

Sot, më datë 27.06.2005, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres Lindita Lleshi, u paraqit personalisht **Alba Gina,** shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më datë 14.04.1977, me banim në Tiranë, Rr. Dervish Hima, nr. 1, ap. 10/ 1, Shqipëri, me pas. nr. Z1019325, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilës u binda pasi pashë dokumentat përkatëse të identifikimit, e cila më deklaroi se këtë Kërkesë e ka Alba Gina, pasi e lexoi dhe e kuptoi, e nënshkroi përpara meje, dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

**Lindita Lleshi**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE